



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 31

Prishtinë, më 27 prill 2012, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Sabri Hamiti, Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Petar Miletqi.

Munguan: Enis Kervan, Shaip Muja, Amir Ahmeti.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati - ZPRK; Shkumbin Beqiri, Florije Mehmeti - KDI; Besarta Zuka, Saranda Pajaziti, Visar Bikliqi - NDI dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albin Kurti – kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportim i ministrit Enver Hoxhaj, lidhur me aktivitetet e deritanishme dhe ato aktuale si dhe planet në vijim të Ministrisë së Punëve të Jashtme;
3. Formimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës;
4. Të ndryshme .

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Raportim i ministrit Enver Hoxhaj, lidhur me aktivitetet e deritanishme dhe ato aktuale si dhe planet në vijim të Ministrisë së Punëve të Jashtme

Enver Hoxhaj - Tha se, së bashku me zv.ministrin Ibrahim Gashi, i janë përgjigjur ftesës së Komisionit që të raportojnë për punën e bërë në MPJ gjatë këtij viti dhe për planet e tyre në vijim.

Ndër prioritetet e MPJ-së, tha se parësore është përmyllja e plotë e njohjes së pavarësisë së Kosovës, prioritet ky i MPJ-së në vazhdimësi që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës.

Njoftoi se MPJ-ja e ka hartuar një strategji vitin e kaluar, e cila në këtë vit është rishikuar dhe janë ndarë në grupe shtetet që janë shumë afër ta njohin Kosovën: shtetet që kanë qëndrim pozitiv sa i përket pavarësisë së Kosovës, shtetet që kanë qëndrim neutral dhe nga ato që e kundërshtojnë haptazi shtetësinë e Kosovës. Prioritet tjetër i Ministrisë theksoi njohjen nga pesë vendet e BE-së, që nuk e kanë njohur Kosovën. Arsye pse këto vende nuk e kanë njohur Kosovën janë më shumë të politikës së brendshme të tyre, sesa nga ato të politikës së jashtme. Prioritet tjetër të MPJ-së, ceku anëtarësimin e Kosovës në organizata, iniciativa, mekanizma rajonal, evropian e global.

Prioritete të radhës, ceku integrimin e Kosovës në strukturat euroatlantike, ku prioritet parasheh liberalizimin e vizave, marrjen e Udhërrëfyesit përmes një faze sikurse vendet e Ballkanit Perëndimor dhe shndërrimin e FSK-së, pas përfundimit të mandatit të saj, në ushtri të Kosovës. Prioritete të tjera i përmendi, diplomacinë ekonomike, diplomacinë publike, vendosjen e marrëdhënieve diplomatike në mes të Kosovës e vendeve që e kanë njohur Kosovën dhe nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale. Ministri njoftoi edhe lidhur me aktivitetet e MPJ-së në diplomacinë parlamentare dhe atë të komuniteteve. MPJ-ja, tha se ka një listë të detajuar sa i përket emërimit të konsujve të nderit të Republikës së Kosovës, në të cilën mund të bëhen propozime konkrete edhe nga Komisioni.

Për të gjitha zhvillimet të cilat i ka Republika e Kosovës, tha se në baza javore, dyjavore e mujore, dërgohen informata tek ambasadat tona, tek shtetet mbështetëse të Republikës së Kosovës dhe tek shtete të tjera, me qëllim të informimit sa më të hollësishëm për atë se çfarë po ndodh në Kosovë. Po ashtu, ministri Hoxhaj njoftoi edhe për procesin e emërimit të ambasadorëve.

Në mbledhje, anëtarëve të Komisionit iu ofrua materiali nga MPJ-ja: Koncepti për pozicionin e Kosovës, Koncepti për zhvillimin e shërbimit diplomatik të Republikës së Kosovës, i cili u tha se ende nuk është përfundimtar, si dhe Strategjia për diplomacinë ekonomike dhe disa libra dhe revista për diplomacinë publike.

Sabri Hamiti - Në diskutimin e tij ritheksoi se në politikën e jashtme dhe në gjendjen në të cilën është Kosova në raport me të tjerët, do të duhej të kishte konsensus në të gjitha institucionet, duke filluar nga Kryetarja e shtetit, Qeveria, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Kuvendi. Nuk ekziston një konsensus në komunikimin diplomatik, në mes të shumë personaliteteve që merren institucionalisht me këtë çështje, gjë që krijon mosmarrëveshje të paarsyeshme për punët të cilat i kanë për detyrë që t'i bëjnë institucionet. Emërimet diplomatike në shërbimin diplomatik të Republikës së Kosovës, nuk duhet të përkufizohen me një ministër dhe për nga spektri politik, sepse nëse do të vazhdohet kështu, ky mision diplomatik jo se nuk do të bëhet konsensual, por do të shkojë kah dështimi. Shërbimi diplomatik duhet të vendoset në bazë të kualiteteve dhe të kriterëve të përfaqësuesve diplomatikë, në këtë fazë të emërimeve dhe rrimërimeve të tyre. Çështja e statusit të personelit diplomatik tha se për shumë arsye duhet të rregullohet me një ligj të veçantë dhe të mos trajtohen me atë të shërbyesve civilë.

Shtroi pyetjen: Pas 3-4 vitesh funksionimi të Shërbimit diplomatik të Kosovës, a janë vlerësuar diplomatët, a ka gradime apo degradime të tyre?

Sipas tij, vlerësimi i diplomatëve duhet bërë në bazë të kontakteve, lidhjeve politike që i krijojnë ata dhe në bazë të asaj se çfarë interesi i krijojnë Kosovës. Lidhur me marrëveshjet e arritura në Bruksel, pyeti se marrëveshja për fusnotën a i pengon njohjet e Kosovës. Kërkoj sqarim për

përdorimin e fusnotës edhe në takimet që nuk janë të karakterit rajonal, përderisa është thënë se fusnota do të përdoret vetëm në takimet rajonale, pasi që Serbia nuk e njeh Kosovën.

Donika Kadaj-Bujupi- Për shkrimin e zv.ministrit Gashi, i cili shkrim gjendet edhe në ueb- faqen e MPJ-së, tha se është bërë një lëshim i madh në atë tekst ku thuhet se Kosova është shkëputur nga Serbia. Përdorimin e termit shkëputje e konsideron një dëm shumë të madh për Kosovën, argument të cilin tha se ne vetë po e japim, përderisa të gjithë e dimë se pavarësia e Kosovës ka ardhur si rezultat i shpërbërjes. Pyetjen tjetër e shtroi lidhur me konkursin, i cili tha se është shpallur para një viti dhe ende po zvarritet dhe nuk dihet nëse ka përfunduar apo është anuluar. Theksoi se në ambasadat tona është vërejtur një politizim i madh i stafit atje dhe raportet jo të mira të tyre në mes vete. Në këtë drejtim shtroi pyetjen se a është ndërmarrë ndonjë veprim për trajnim të stafit diplomatik, pasi që roli i tyre nuk është militant, as partiak, por përfaqësues dhe në interes të vendit. Duke u ndërlidhur me prioritetin e MPJ-së për diplomacinë ekonomike, pyeti se cilat janë sfidat apo problemet që po ballafaqohen në raport me investitorët dhe mungesën e tyre.

Hydajet Hyseni- Theksoi se është i nevojshëm një bashkëpunim më i rregullt Ministri-Komision, ngase mungesa e komunikimit sistematik ka bërë që Komisioni mos të ketë një pasqyrë reale nga ajo që po ndodh. Po ashtu, theksoi se edhe për aktivitetet e tjera të natyrës së punëve të jashtme, Komisioni nuk po njoftohet dhe kjo lë përshtypjen sikur dëshirohet që të izolohet nga këto aktivitete. Në aktivitetet e punëve të jashtme tha se ne duhet të jemi të bashkuar dhe t'i harmonizojmë qëndrimet. Në procesin e bisedimeve me Serbinë, Komisioni nuk ka pasur qasje adekuate dhe mos shtrirja e këtyre çështjeve në Komision, e bën që ato të shtrohen aty ku bie rasti. Lidhur me prioritetin e MPJ-së mbi njohjet, propozoi që të vlerësohet efekti i arritur në këtë proces dhe se a do të duhej të vazhdohej me këmbëngulje me një shtet, i cili nuk i ka sjellë rezultatet e duhura. Përkrahë frymën e dialogut, por duhet shikuar atë që është në interes thelbësor të vendit dhe se cili është bilanci i atij dialogu. Shqiptarët e Luginës së Preshevës, tha se kanë kontribuar dhe janë sakrifikuar shumë, ndërsa tani janë duke u diskriminuar nga Republika e Kosovës, e për të cilët ne duhet bërë lehtësime, siç ka bërë edhe Shqipëria ndaj qytetarëve të Kosovës. Shërbimit diplomatik të Kosovës do të duhej mundësuar që të punojë në kushte dinjitoze, si dhe shërbimeve konsullore duhet ndihmuar me staf plotësues të përkohshëm, për përballimin e punëve në rastet e nevojshme. Çështje e cila kërkon adresim të shpejtë, tha se është trajtimi i diplomatëve me standardet dhe shpenzimet e vendit ku ata veprojnë.

Skender Hyseni - Shtroi mosdiskutimin nga ministri lidhur me çështjen e dialogut dhe marrëveshjeve si pjesë të politikës së jashtme. Kjo krijon përshtypjen se ka një politikë të jashtme tërësisht të çakorduar, përkatësisht se MPJ-ja dhe Ministri i Jashtëm janë krejtësisht të anashkaluar në këtë proces. Kjo përshtypje tha se u konfirmua nga fakti se ministri nuk bëri përpjekje të njoftojë se a ka pasur ndikim në procesin e njohjes së Kosovës fusnota dhe pse, çështje për të cilën kërkoj përgjigjen nga ministri. Në vazhdim, pyeti: A mund të konfirmohet se Nigeria dhe Gana e kanë njohur Kosovën, a ka mundësi që në ndonjë vend të krijohet përshtypja nga dikush që flet në emër të Kosovës, ndonjëherë mund të përdorë edhe metoda korruptive për të përfituar? Çka është bërë dhe sa bëhet që të njoftohen qendrat kryesore të vendosjes për një angazhim për t'i sjellë Kosovës njohje të mëtejme? Studimi i fizibilitetit tha se nuk do të thotë asgjë, përderisa pesë shtete të BE-së ende nuk e kanë njohur Kosovën. Në këtë drejtim, Kosova duhet të kërkojë angazhim më të madh nga Komisioni Evropian. Sa i përket dialogut, tha se e mbështetë dhe ai duhet vazhduar, por nuk do të thotë që të bëhen patjetër koncesione. Për diskutimin mbi shkrimin për shkëputjen e Kosovës, tha se GJND-ja si fakt parësor të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ka konstatuar shpërbërjen e dhunshme të ish- Jugosllavisë.

Petar Miletiq- Në mes të tjerash, në diskutimin e tij propozoi një bashkëpunim më të madh me Kanadanë, nga se ajo është e interesuar për ta njohur më shumë Kosovën dhe për të investuar në Kosovë.

Albin Kurti- Theksoi se nga MPJ-ja është kërkuar që t'i sillen Komisionit kopjet e notave verbale të shteteve të cilat e kanë njohur Kosovën. Këto ende nuk na janë sjellë dhe është në interes të Komisionit për ta pasur përshtypjen se cili shtet, kur dhe si e ka njohur Kosovën. Në diskutimin e tij, ministrit Hoxhaj i shtroi këto pyetje: A është e vërtetë se Ahmet Shalën e keni emëruar për ambasador në Japoni, ose a e keni në plan ta emëroni? Nëse vazhdojmë me këtë ritëm të prezantuar të njohjeve, a do t'i bie që deri në vitin 2020 të ngelim pa njohje të plotë ndërkombëtare? Për çfarë ka qenë ministrja Çitaku me ju në vizitën e fundit në SHBA, pasi nuk ndërlidhet me kompetencat e MIE-së dhe duke e pasur parasysh buxhetin tonë të varfër? Si është e mundur që asnjëherë nuk e keni vlerësuar të duhur prezencën e ndonjë anëtarit të Komisionit në shoqërimin e juaj në vizita jashtë vendit, përderisa me akte normative parashihet? Në kuadër të diplomacisë publike dihet se ka qenë konferenca “Gërmia Hill”, ku nuk është ftuar asnjëri nga anëtarët e Komisionit. Kur do të mund të na e sillni raportin financiar për fushatën e lobimit për njohjen e pavarësisë së Kosovës? A mendoni se politika e jashtme ka qenë e organizuar mirë, me dy zv.kryeministra që merren me punë të jashtme, me ministrat Çitaku e Makolli, që po ashtu janë përbrenda këtij resori dhe brenda kësaj sfere? A është tregtia e jashtme pjesë e politikës së jashtme dhe nëse po, si? Çfarë mendoni ju për bisedimet Kosovë-Serbi që kanë nisur më 8 mars 2011, për marrëveshjet e deritanishme dhe posaçërisht për fusnotën, a ishte ajo e drejtë dhe a ishte e dobishme? A janë marrëveshjet me Serbinë marrëveshje ndërkombëtare? Qeveria dhe ju a e njihni Republikën e Serbisë? Cili ka qenë angazhimi i juaj për arrestimet e fundit në kufi që i ka bërë Serbia, sulmin terrorist në veri të Mitrovicës, ku u vra Selver Haradinaj dhe cili ka qenë aktiviteti i MPJ-së, sa i përket komunikimit, letrave dhe çështjeve që i keni ngritur lidhur me këto zhvillime aspak të zakonshme? Si është emëruar Ajmone Veseli zv.konsulle, e si është graduar Naser Idrizi, pa u mbledhur Komisioni për gradime? A është e vërtetë se do t'i dërgoni ambasadorët tanë për trajnim në SHBA dhe çfarë kosto financiare do të ketë ky trajnim? A e keni paralajmëruar zyrtarisht themelimin e Akademisë Diplomatike, a keni plan strategjik për këtë është një lloj ideje fillestare publike apo ka nismë zyrtare për këtë? A është e vërtetë që ambasadorin në SHBA, Avni Spahiun do ta emëroni ambasador në Holandë? A keni ndërmarrë ndonjë hap për t'i kumtuar qeverisë së Belgjikës se ambasadori atje do të vazhdoj të qëndrojë?

Enver Hoxhaj- Duke u përgjigjur në pyetjet e deputetit Sabri Hamiti, lidhur me konsensusin në politikën e jashtme, tha se është duke bërë përpjekje maksimale që të koordinohen me të gjithë përfaqësuesit dhe krerët e të gjitha partive. Si ministër i MPJ-së, tha se për çdo vizitë që bën i njofton të gjithë duke përfshirë edhe kryetarin e partisë së tij dhe është në dispozicion për çdo parti politike, që sa i përket politikës së jashtme të ketë një konsensus dhe mendon se kjo punë është duke ndodhur.

Sa i përket meritave për njohje, tha se nuk bën përpjekje t'i marrë këto merita, njohjet janë meritë e qytetarëve të Kosovës. Njoftoi se deri tani askush nuk është larguar nga Shërbimi i jashtëm i Republikës së Kosovës. Mbështetë nisjen për rishikimin e Ligjit për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës. Sa i përket marrëveshjeve me Serbinë, atë të menaxhimit të kufijve dhe të fusnotës dhe efektet e saja në njohje, nga përvoja theksoi se Kosovën e kanë njohë gjithë ato vende që kanë qenë pjesë e ndërtimit të saj. Kosovën nuk e njohin disa vende për shkak të problemeve që kanë brenda për brenda tyre. Njohja është fenomen i një gjeografie globale dhe një proces padyshim i pakthyesëm.

Sabri Hamiti- Lidhur me konsensusin në politikë të jashtme, tha se ka menduar kur në thelbin e veprimit ekziston konsensusi institucional. Ndërsa lidhur me Shërbimin diplomatik tha se propozimi i tij ka qenë që të emërohen diplomatë kualitativë, e jo militantë, sepse është në të mirë të vendit.

Enver Hoxhaj- Në raportimin e prezantuar, tha se ne kemi konsensus nga objektivi i parë për përmbylljen e procesit të njohjes së plotë të pavarësisë së Kosovës e deri tek objektivat e tjera. Ideja që ta kemi një dokument për politikë të jashtme dhe që t'i kemi disa parime të përbashkëta me KPJ-në e institucionet e tjera, do të jetë korniza më e mirë e arritjes së këtij konsensusi.

Sabri Hamiti- Për dokumentin, i cili i është shpërndarë anëtarëve të Komisionit, si një formë elementare, tha se vërehet një dëshirë eventuale për ta bërë këtë që e quani konsensus. Konsensusi në politikën e jashtme ka të bëjë me interesat e vendit. Propozoi që ministri në vizitat jashtë vendit të shoqërohet edhe me ndonjë nga anëtarët e Komisionit, pavarësisht se cilës parti i takon ai deputet.

Enver Hoxhaj- Lidhur me pyetjen e deputetes, D. Kadaj Bujupi, për tekstin për “shkëputje” tha se do të njoftohet nga zv.ministri I. Gashi.

Donika Kadaj Bujupi- Shtroi çështjen se si do të shpjegohet ky shkrim, nëse në një takim të radhës do të dalë ky dokument dhe kundërshtarët e pavarësisë do të thonë se ju vetë po pajtoheni se ka ndodhë kjo shkëputje.

Ibrahim Gashi- Lidhur me shkrimin tha se ai shkrim përmban pikëpamjet e tij, qëndron prapa atij shkrimi dhe nuk e shef atë ashtu siç thuhet. Në vazhdim, ai shpjegoi se termi shkëputje është përdorur në kuptim të veprimit praktik të fitimit të lirisë e jo si term absolutisht formal. Nëse Komisioni vlerëson se shkrimi mund të ketë efekte negative tha se atë mund ta tërheqë nga ueb - faqja dhe se ky shkrim nuk është publikuar me kërkesë të tij.

Donika Kadaj Bujupi- Insistoi që Qeveria të distancohet nga ky shkrim, ngase është në të mirën e Kosovës.

Enver Hoxhaj- Duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të Komisionit, tha se për konkursin e MPJ-së të shpallur para një viti, jemi të interesuar që ai të jetë funksional nga gjysma e dytë e këtij viti. Stafi diplomatik mban trajnime dhe rikualifikime të ndryshme, për këtë kemi bashkëpunim me të gjitha akademitë diplomatike dhe çdo vit dërgohet një numër i caktuar i stafit diplomatik në përputhje me prioritetet tona që të trajnohet në fusha të caktuara. Lidhur me investitorët, MPJ është në shërbim të ministrive të linjës po ashtu edhe ambasadat tona e dinë saktësisht se me cilën linjë duhet të komunikojnë në këtë drejtim. Nuk është përpjekja ime për marginalizim të Komisionit apo injorim të tij dhe jam i gatshëm që gjithë agjendën ta ndaj me Komisionin.

Njoftoi se nuk do të ketë reduktim të përfaqësimit të Kosovës në Evropë. Sa i përket kushteve jo dinjitoze të stafit, tha se ambasadorët tanë paguhen më mirë se çdo ambasador tjetër i rajonit, ndërsa arsye që të ankohen për paga ka stafi administrativ.

Shërbimet konsullore ndihmohen me staf nga MPJ-ja. Në vitin e kaluar janë dërguar 10 punëtorë për gjashtë muaj, ndërsa këtë vit janë dërguar edhe pesë punëtorë për të ndihmuar në kërkesat të cilat i ka mërgata jonë. Lidhur me pyetjen e deputetit S. Hyseni, për mos raportim për marrëveshjet dhe bisedimet teknike me Serbinë, tha se i është përmbajtur ftesës së Komisionit që të raportojë për

aktivitetet e MPJ-së. Shprehu gatishmërinë që të bisedoj edhe për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë por theksoi se zv.kryeministria E. Tahiri e ka këtë përshkrim të punës dhe ajo mund të jap informata shumë më të detajuara. Ai tha se, nuk kemi politikë të jashtme të çakorduar, kemi një koordinim të plotë dhe çdo informatë që e kam e ndaj me ministrinë e tjera.

Skender Hyseni- Në mes tjerash theksoi se kur flet për politikën e çakorduar, i ka parasysh deklaratat e bartësve të politikës së jashtme të Kosovës dhe se qëllimi i tij është fuqizimi i rolit të ministrit të MPJ-së. Në këtë drejtim, shtoi pyetjen: Ku qëndron koordinimi në politikën e jashtme nëse ministri i MPJ-së nuk është në dijeni për detajet e një marrëveshjeje që bie në kuadrin e politikës së jashtme?

Enver Hoxhaj- Ne si MPJ, tha se kemi koordinim të plotë me zv.kryeministren Tahiri sa i përket dialogut dhe jo çdo gjë që ndodhë në politikën e jashtme thuhet në media. Se a ka pasur ndikim fusnota në shpejtësinë dhe numrin e njohjeve tha se, GJND në mënyrë decizive thotë se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk e ka shkelë të drejtën ndërkombëtare dhe Rezolutën 1244. Gana formalisht e ka njohur pavarësinë e Kosovës dhe e ka dërguar notën verbale, ndërsa presidenti i Nigerisë, e ka dërguar një letër e cila në interpretimin tonë është njohje e Kosovës dhe jemi në kontakt që të marrim edhe notën verbale nga ky vend. Në vizitën e fundit në SHBA, zyrtarisht ja kemi dorëzuar sekretares së shtetit një listë të vendeve, për ta mbështetur Kosovën në procesin e njohjeve, në baza të njëjta kemi vepruar edhe me Britaninë e Madhe, Francën, Gjermaninë dhe me vendet e tjera të cilat kanë ndikim. Sa i përket studimit të fizibilitetit, ai është hapi i parë i rëndësishëm drejt arritjes së Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit. Kemi hartuar disa shkresa informuese për ministra të vendeve anëtare të BE-së, sa i përket pasojave që mund t'i ketë Kosova, nëse Serbia lëviz nga agjenda evropiane pa kushte. Marrëveshja për menaxhimin e integruar të kufijve është marrëveshje ndërshtetërore legale mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Është e vërtetë se kjo marrëveshje nuk është ratifikuar nga Serbia. Komisionit do t'ia sjellim notat verbale posa t'i kemi nga Presidenca, të gjitha. I kemi sugjeruar znj. Presidente që z. Ahmet Shala të emërohet ambasador në Japoni. Ambasadori aktual në Japoni është i interesuar të kthehet në pozitën e drejtorit të përgjithshëm në MPJ.

Sa i takon njohjes së plotë, qëllimi ynë është që të arrihet një numër kritik i njohjeve të Kosovës, që në vitin e ardhshëm t'i qasemi strategjisë se si të anëtarësohet Kosova në organizma dhe institucione globale. Vizita e ministres Çitaku në SHBA, ka pas për qëllimin shqyrtimin e mundësisë që të vizitohet SHBA, pa viza. Programi i MPJ-së gjendet në ueb-faqe, ndërsa sa i përket strategjisë për njohje juve ju është shpërndarë dokumenti, pa listën e vendeve se kush mund ta njoh dhe kush nuk mund ta njoh Kosovën. Komisionit do t'ia dërgojmë raportin financiar për lobim. Ne kemi bërë përpjekje maksimale që të koordinohemi në mes të ministrive dhe të bashkëpunojmë.

Se a duhet të jetë tregtia e jashtme pjesë e politikës së jashtme, tha se si ministër i MPJ-së në çdo vizitë në rajon e Evropë, kam bërë përpjekje që të ftoj investitorët e huaj, që ta vizitojnë Kosovën për mundësi investimi. Marrëveshjet ndërmjet Serbisë dhe Kosoves, sipas interpretimit tonë janë ndërkombëtare. Kosova nuk e njeh Republikën e Serbisë. Rreth arrestimeve të Serbisë dhe sulmeve terroriste në Mitrovicë, njoftoi se ka shkruar disa letra, telefonata dhe ka zhvilluar disa takime në nivel të ministrave të punëve të jashtme të anëtarëve të BE-së. Ministri njoftoi edhe për lëvizjet e bëra të stafit diplomatik, znj. Veseli, znj. Dhurata Selimin e Naser Idrizin. Qeveria ka marrë vendim që të themelohet Akademia diplomatike, mënyra më e mirë për funksionalizim e këtij vendimi do të ishte përmes emërimit të drejtorit të Akademisë. Avni Spahiu është i propozuari ynë për ambasador në Holandë. Ambasadori ynë në Belgjikë vazhdon të qëndrojë në Belgjikë, për këtë është njoftuar ministri i Punëve të Jashtme të Belgjikës.

Albin Kurti –Kërkoi të informohet nga ministri se kur do të mund t’i kenë anëtarët e Komisionit kopjet e notave verbale, si dhe kur i është prezantuar Komisionit lista për ambasadorë në Japoni dhe Holandë. Për vizitën e ministres Çitaku në SHBA, për të biseduar lidhur me vizat tha se është çështje e MPJ-së, e jo e Ministrisë së Integrimeve.

Lidhur me konferencën “Gërmia Hill” ku nuk është ftuar asnjë anëtar i Komisionit, pyeti se a është ndërmarrë ndonjë masë në MPJ për këtë lëshim, ndërsa për trajnimin e stafit diplomatik dhe formimin e Akademisë diplomatike, pyeti nëse MPJ ka ndonjë plan buxhetor paraprak.

Enver Hoxhaj -Sa i përket mosftesës së anëtarëve të Komisionit në konferencën “Gërmia Hill” , tha se ka qenë një lëshim i yni, i cili nuk do të përsëritet. Kopjet e notave verbale dhe shkresat e tjera do t’ia përcjellin Komisionit deri në fund të muajit maj. Sa i takon listës së ndërrimeve të ambasadorëve në Japoni dhe Holandë, tha se ky rrotacion ka ndodhur për shkak se ishte e nevojshme për fillimin e vitit shkollor të fëmijëve të tyre dhe për arsye të tjera. MPJ-ja synon që ta ketë një koordinim të plotë, sa i përket politikës së tregtisë së jashtme dhe kjo në të ardhmen duhet të rregullohet.

3. Formimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës

Komisioni formoi grupin e punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës në përbërje:

1. Albin Kurti – kryesues,
2. Hydajet Hyseni – anëtar,
3. Donika Kadaj-Bujupi – anëtarë.

Takimi përfundoi në orën 12:50.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti